

Në kuadër të "Ditëve të Informimit", Ministria e Arsimit, në bashkëpunim me Universitetin "Eqrem Çabej", zhvilluan panairin "Work & Study 2026".

Gjatë këtij aktiviteti, maturantët patën mundësinë të njihen nga afër me programet e studimit dhe opsionet akademike.

Takimet informuese u zhvilluan në qytetet:

Vlorë

Berat

Gjirokastrë

Sarandë

Gjatë panairit, Universiteti "Eqrem Çabej" prezantoi programet e studimit, mundësitë e mobilitetit ndërkombëtar dhe praktikat profesionale, duke ndihmuar maturantët të krijojnë një ide më të qartë për rrugën e tyre akademike.

